

KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 25 Gusht 2022 , u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

I. **Z. Ilir Varfi**, shtetas shqiptar, lindur më 19.01.1989, në Sarandë, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr.I90119048A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 50% të kuotave/pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë “RISTRETO” SH.P.K, me nr. NUIS: L81501009V, nga këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”,

dhe

II. **Z. Altin Çela**, shtetas shqiptar, lindur më 13.06.1974, në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal H40613041P, nga këtu e më poshtë referuar si “**Blerësi**”.

Neni 1 Objekti i kontratës

1.1 Objekti i kontratës është shitja nga shitësit kundrejt blerësit, të 50% (pesëdhjetë përqind) kuotave të kapitalit të shoqërisë “Ristreto” SH.P.K, me një vlerë të përgjithshme prej 50,000 ALL (pesëdhjetë mijë Lekë), që Shitësi zotëron në shoqërinë “RISTRETO” SH.P.K.

1.2 Struktura e pronësisë, pas shitjes së kuotave do të jetë:

- 50% të kuotave të kapitalit do të zotërohen nga Z. Marenglen Skëndi;
- 50% të kuotave të kapitalit do të zotërohen nga Z. Altin Çela.

Neni 2 Çmimi i shitjes.

2.1 Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është 50,000 ALL (pesëdhjetë mijë Lekë).

Neni 3 Mënyra e pagesës

3.1 Çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likujduar nga blerësi cash.

Neni 4
Detyrimet e shitësit

- 4.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë “RISTRETO” SH.P.K, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.
- 4.2 Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.
- 4.3 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

Neni 5
Detyrimet e Blerësit

- 5.1 Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.
- 5.2 Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 6
Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

- 6.1 Kjo kontratë hartohet në 2 ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.
- 6.2 Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 6.3 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Z. Ilir Varfi



BLERËSI

Altin Çela

